

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“e-LAVA“

Sot, me date 05.05.2023:

• **Z. Marin Shpata**, qytetar shqiptar, lindur ne Tirane, me 26.02.1983, rezident ne Tirane, Rruga Budi, 2, Vila nr.8, me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i kartes se identitetit nr. 032771203/numer personal I30226131V mbeshtetur ne Ligjin Nr.9901 date 14.04.2008, “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, ka vendosur te krijoje shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar te quajtur “ e-LAVA” shpk me aktin e themelimit si vijon:

FORMIMI I SHOQERISE

Neni 1

Formohet shoqeria tregtare e quajtur “e-LAVA” sh.p.k.

SELIA E SHOQERISE

Neni 2

Selia e shoqerise tregtare “e-LAVA” shpk do te jete ne Tirane, Njesia Bashkiake nr.10, Rruga e Kavajes, Godina nr.123.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Neni 3

Shoqeria do te kete objekt veprimtarie:

- larje automjete;
- sherbim DDD(Dezinfektim, Dezinsektim, Deratezim);
- import – eksport, blerje - shitje, tregtim te automjeteve, makinerive, pajisje te ndryshme industriale;
- import – eksport, blerje - shitje, tregtim te artikujve te ndryshem ushqimore;
- blerje, shitje, marrje me qera dhe administrim te pasurive te luajtshme e te paluajtshme ne Shqiperi dhe jashte saj;

Shoqeria, brenda kufijve ligjore, mund te kryeje çdo operacion qe lidhet me pasurite e luajtshme dhe te paluajtshme, mund te kryeje operacione industriale dhe tregtare te nevojshme apo te dobishme per realizimin e qellimeve te saj, mund te marre pjese drejtperdrejt ose indirekt ne pjesemarrje ne shoqeri ose subjekte te tjera ne Shqiperi ose jashte saj, te cilat kane objekt te njejte ose te ngjashem ose te lidhur me te vetin.

Neni 4

Per kryerjen e veprimtarise se saj Shoqeria mund te hape zyra te tjera, njesi perpunimi, sherbimi tregetimi dhe te bashkepunoje me persona fizike dhe juridike, vendas dhe te huaj.

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Neni 5

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me afat te pacaktuar.

KAPITALI SHOQERISE, KONTRIBUTET DHE KUOTAT

Neni 6

Kapitali fillestar i shoqerise tregtare "**e-LAVA**" **shpk** do te jete i barabarte me Leke 100.000(njeqind mije) dhe do te perbehet nga kuota e ortakut themelues te shoqerise.

Kapitali themeltar ndahet ne 1(nje) kuote, me vlere nominale prej 100.000 (njeqind mije) leke.

Z. Marin Shpata, qytetar shqiptar, lindur ne Tirane, me 26.02.1983, rezident ne Tirane, Rruga Budi, 2, Vila nr.8, me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i kartes se identitetit nr. 032771203/numer personal I30226131V ka ofruar nje kontribut ne para te barabarte me 100.000 (njeqind mije) leke.

Sipas kontributit te siperpermendur shoqerise z. Marin Shpata, i perket 1(nje) kuote, qe i korrespondon 100% (njeqind per qind) te kapitalit te Shoqerise.

Neni 7

Kuotat e kapitalit te shoqerise dhe te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te transferohen sipas parashikimeve ne Statut dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi.

ORGANIZIMI I SHOQERISE

Neni 8

Organi vendimmarres i Shoqerise eshte Ortaku Themelues.

Neni 9

Ortaku Themelues ka te drejte te emeroje nje apo me shume administratore, te cilet jane perfaqesuesit ligjore te shoqerise ne menyre kolegjiale. Ata mund te nderrmarrin te gjitha veprimet e zakonshme dhe te jashtezakonshme te administrimit, por gjithmone brenda kufijve qe u jep atyre Statuti i shoqerise.

Neni 10

Konfliktet qe mund te lindin midis paleve do te gjykohen dhe zgjidhen ne zbatim te legjislacionit shqiptar.

Neni 11

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe veçanerisht te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregetare".

Neni 12

Akti i themelimit, u perpilua ne 2(dy) kopje ne gjuhen shqipe, per t'iu shperndare organeve kopetente dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise tregetare "e-LAVA" sh.p.k.

Akti i themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortaku themelues.

ORTAKU THEMELUES

Z. Marin Shpata

MARIN SHPATA

